

PHI LAN THR OPY

edizioni 5

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI
Land
THR
OPY

hapësirë e dedikuar
për FILANTROPINË

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

9

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik
Janar - Dhjetor 2022

23

Java e Filantropisë
2022

28

Intervista me
përfaqësues të nismave
filantropike në vend

Ina Malhani
Luis Artoni

38

Rrathë Dhurues

44
Smile.al

49
Fushata në ndihmë të
personave në nevojë
Korrik - Dhjetor 2022

51
Fondacionet Komunitare
Asistenca ndaj
Fondacioneve Komunitare

53
Zhvillime nga Evropa

Mirë se erdhët në edicionin e pestë të revistës Philanthropy!

"Philanthropy" është revista e vetme në Shqipëri, dedikuar zhvillimit të aktivitetit filantropik në vend.

Në këtë edicion, ju do të njiheni me nismat dhe aktivitetet e organizuara gjatë muajve korrik - dhjetor 2022.

Një fokus të veçantë zënë të **dhënat dhe faktet nga monitorimi vjetor i aktivitetit filantropik**, si dhe **trendet e dhurimit ndër vite**.

E kthyer tashmë në një traditë, gjatë muajit nëntor u organizua **"Java e Filantropisë 2022"**. Gjatë kësaj jave u organizuan një seri aktivitetesh për të rritur ndërgjegjësimin, promovimin, aktivizimin dhe debatin publik veçanërisht të të rinjve, mbi rëndësinë që ka ky aktivitet për zhvillimin e shoqërisë.

R
r
e
t
h
n
e
s
h



Në dhjetor u inagurua “**Nadja e mirë gjyshërit tanë**”, një nga nismat e mbështetuara përmes “Rrathë Dhurues, 2022”. Tashmë të moshuarit e qytetit të Shkodrës, do të kenë një park më shumë. Romina Kali, përfaqësuese e shoqatës “Roots” përshkruan rrugëtimin dhe realizmin e kësaj nisme dhe rëndësinë e nismave të tilla rinore në mbështetje të komuniteteve.

Gjithashtu, në këtë publikim kemi kënaqësinë t`ju prezantojmë edhe iniciativat e Znj. Ina Malhani, dhe Z. Luis Artoni në mbështetje të grupeve në nevojë.

Nëntë nisma fituese të organizatave jofitimprurëse u shpallën në **platformën crowdfunding Smile.al**. Përmes kontributit nga individë dhe biznese, dhurimet do të adresojnë nevoja të komuniteteve lokale kryesisht të fokusuara në fushat e shëndetësisë, edukimit dhe veprimtarisë sportive.

Qendra Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL) shpalli në dhjetor “**Hartëzimi i gjenerimit të të ardhurave për OJF-të: Një Udhëzues Monitorimi për Mjedisin Mundësues për Aktivitetin Filantropik**”. Udhëzuesi ofron mundësinë për të vlerësuar mjedisin ligjor dhe rregullator mbi dhurimet filantropike. Qëllimi i këtij udhëzuesi është identifikimi i praktikave më të mira, si dhe sfidat që kanë nevojë për përmirësime.

Vijon asistenca për organizatat dhe grupet joformale të cilët synojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre si fondacione komunitare në vend. Njihuni me një nga nismat e zbatuara.

Partnerët Shqipëri si pjesëmarrëse në një seri tryezash dhe takimesh rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare të organizuara nga Rrjeti Global WINGS dhe Inicativa Evropiane për Fondacionet Komunitare (ECFI) ka promovuar zhvillimet më të fundit në vend dhe sfidat në lidhje me mjedisin mundësues mbi aktivitetin filantropik.

Revista është një platformë diskutimi dhe nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek kkeruti@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!



T Ë D H Ë N A
R R E T H
A K T I V I T E T I T
F I L A N T R O P I K

J A N A R - D H J E T O R 2 0 2 2


Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2022, bazuar në monitorimin ditor të medias së shkruar, vizive dhe sociale, si edhe publikime të institucioneve publike dhe jo-publike gjatë periudhës janar - dhjetor 2022.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.


Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Përmes një monitorimi të kujdesshëm ditor të dhurimeve, gjatë vitit 2022, u regjistrua një numër prej **64,001 dhurimesh** me një vlerë dhurimi prej **460,366,227 Lekë (4,361,100 Euro)**.

Numri i dhurimeve sipas natyrës




Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë



Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

Dhurimet sipas formës

168 dhurime përmes **Eventeve**
124 dhurime në formë të **Drejtëpërdrejtë**
63,709 dhurime përmes **Fushatave**



DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins (50)
- #2 Grupi Balfin (13)
- #3 Raiffeisen Bank Shqipëri (13)
- #4 Vodafone Albania (13)
- #5 Vizion OJF (12)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#1 Individë 71,519,443 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve për Romario Dragani, i cili ndodhej në rrezik për jetën prej një aksidenti automobilistik.

#2 Bankers Petroleum 56,650,000 Lekë

Kontribut për zhvillimin e infrastrukturës rrugore në disa zona në Fier.

#3 Individë 21,741,984 Lekë

Fushatë crowdfunding për të ndihmuar Omerin, një djalë i vogël me probleme shëndetësore nga Kosova.

3 DHURUESIT MË TË MËDHENJ

sipas vlerës së dhurimeve

- #1 Bankers Petroleum 56,650,000 Lekë
- #2 Banka Amerikane e Investimeve 11,480,000 Lekë
- #3 Banka Credins 1,464,683 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve

227

Thirrje për Dhurime

40

Fushata përmes Medias Sociale & Platformave Crowdfunding

2

Fushata përmes medias sociale

17

Megafushata

115

Fushata përmes platformave Crowdfunding

3

Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*

Evente

92



Evente live

1

Event online


*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*




*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.


Vlera sipas natyrës së dhuruesit



Përfituesit Përfundimtar



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (98.2%)
- Zonë Specifike (0.58%)
- Publik i gjerë (0.8%)
- Që jetojnë në vende të tjera (0.42%)





- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (87.53%)
- Të moshuar (11.37%)
- Gra dhe vajza në rrezik (1.1%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (99.64%)
- Zonë Specifike (0.24%)
- Të talentuar (0.08%)
- Fëmijë dhe të rinj (0.04%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë vitit 2022, **51.8%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



*Lushnje, Sarandë, Gjirokastrë, Vlorë, Mirditë, Dibër, Berat, Lezhë, Bulqizë, Kavajë, Klos, Kolonjë, Librazhd, Përmet, Tepelenë, Tropojë.




E panjohur



Kosovë





Shtetas të huaj




Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

70.2% e dhurimeve janë kryer nga dhurues brenda Shqipërisë, ndërsa 29.8% nga dhurues jashtë vendit.



* Mat, Vlorë, Dibër, Lezhë, Korçë, Shkodër.



Diaspora 28.82%

E panjohur 0.87%


Shtetas
të huaj 0.05%

Gjatë vitit 2022, **6 fushat kryesore** të dhurimeve janë si më poshtë:


Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: *Përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore* (0.01%), *Mbrojtjen e kafshëve* (0.07%), *Infrastrukturën publike* (0.06%), *Zhvillimin komunitar* (0.04%), *Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit* (0.05%), *Zhvillimin ekonomik* (0.06%), *Sport* (0.02%), *Të Drejtat e njeriut/Angazhimin qytetar* (0.005%), *Dhurimet sezonale* (0.10%) dhe *Përkrahjen e shkencës* (0.002%).

Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Zbutja e varfërisë
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Edukim
- Aktivitete fetare
- Art dhe kulturë
- Tjetër



Kanalet e dhurimit



ARTIKUJ EMISIONE LAJME
 REPORTAZHE ARTIKUJ EMISIONE LAJME
 KRONIKA REPORTAZHE ARTIKUJ EMISIONE LAJME
 POSTIME REPORTAZHE
 KRONIKA POSTIME
 KRONIKA POSTIME

616

lajme në media

Në vitin 2022, janë gjurmuar 616 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushatat dhe iniciativat dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale, Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.

Në të njëjtë kohë, media vizive ka prodhuar një numër të pasur emisionesh dhe reportazhesh të fokusuar në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme

PHI LAN THRO PY WEEK



make
it the
way to...

#bringChange





J A V A E
F I L A N T R O P I S Ë



7 - 1 1 N Ë N T O R 2 0 2 2

Gjatë datave 7 – 11 nëntor 2022, u organizua “Java e Filantropisë 2022”. Si pjesë e saj u organizuan një seri aktivitesh për të rritur ndërgjegjësimin, promovimin, aktivizimin dhe debatin publik, veçanërisht të të rinjve, mbi çështje të aktivitetit filantropik në vend.

J A V A E F I L A N



1 Leksione të hapura me studentë të Fakultetit të Shkenave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

Tre leksione të hapura u organizua gjatë javës së filantropisë me studentë të vitit të tretë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

Tema e leksionit ishte: "**Roli ekonomik dhe social i aktivitetit filantropik në Shqipëri**". Të rinjtë u njohën me disa nga nismat filantropike, si dhe platforma që mundësojnë dhurimet ndaj komuniteteve në nevojë. Pavarësisht se diskutimi mbi aktivitetin filantropik ishte një temë e re për studentët, përmes pyetjeve ata shfaqën shumë interes dhe shprehën mendimet e tyre lidhur me mënyrën e marrjes së informacioneve, rëndësinë që kanë dhurimet individuale dhe mbështetja nga biznesi, dhe vlerat që mbart ky aktivitet për zhvillimin e komuniteteve lokale. Përfshirja e të rinjve në nisma të tilla ishte një nga çështjet e diskutimit. Dy çështje që u rekomanduan nga të rinjtë ishin ndarja e informacionit për iniciativat filantropike dhe vendosja e një bashkëpunimi të formalizuar me institucionet akademike me qëllim realizimin e aktiviteteve me të shpeshta në këtë fushë.

TROPISË 2022

2

Prezencë në media



Znj. Kostandina Kërutë, në emisionin “Mirëmëngjes Shqipëri” dhe “Ditë pas Ditë” tek Radio Televizioni Shqiptar, promovoi nismat e organizuara nga Partnerët Shqipëri në mbështetje të aktivitetit filantropik në vend.

“Filantropia ka një histori të sajën të lidhur me kushtet shoqërore, ekonomike dhe historike nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare. Për vlerën humane, sociale dhe ekonomike që mbar, ky aktivitet po merr gjithnjë e më tepër vemendje nga grupe të ndryshme të interesit, dhe po përpqemi të angazhojmë më së shumti të rinjtë për avancimin e nismave të tilla”

3

Takim Joformal - Partnerët bëhen bashkë!

Gjatë javës së filantropisë, u organizua një takim jo formal “Partnerët Bëhen Bashkë”. Organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të sektorit privat, sipërmarrës sociale nga vendi dhe rajoni u bashkuan për të ndarë disa nga arritjet prej bashkëpunimeve të deritanishme, dhe diskutuar për nisma të reja në të ardhmen.



QUIZ



4

Të njihemi me pionerët e filantropisë

Kjo fushatë kontribuoi në rritjen e informimit publik mbi figura të shquara shqiptare në këtë drejtim si dhe në rritjen e mirënjohjes publike për individë të cilët nuk jetojnë, por që kanë dhënë një kontribut të vyer për zhvillimin e edukimit shëndetësisë, sportit, e në fusha të tjera. Përmes një kuizi të organizuar në median online Partnerët Shqipëri promovoi dy figura të shquara si z. Tef Pogu, dhe Ali Adil Agjah Bej Biçakçiu.



Z. Pogu

Z. Pogu ka dhënë kontributin e shquar të shumëanshëm dhënë gjatë viteve 1920 - 1944 në mbështetje të personave e grupeve në vështirësi ekonomike në qytetin e Shkodrës, e në veçanti për kontributin në fushën e zhvillimit ekonomik dhe edukimit, përmes hapjes së fabrikave, mencës për personat pa përkrahje, mbështetjes për shkollën fillore të “Motrave Stigmantine” dhe shkollës “Filip Shiroka” etj.




Z. Biçakçiu

Z. Biçakçiu ka dhënë kontributin e tij të vyer kontributin e shquar në zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar, duke shënuar rastin e parë filantropik në Shqipëri të dhurimit të të gjithë pasurisë në shërbim të arsimit.


5 Trendet e dhurimit

Bazuar në monitorimin ditor të medias së shkruar, vizive dhe sociale, si edhe publikime të institucioneve publike dhe jo-publike që prej vitit 2015 vërehet një rritje e trendit të dhurimit për nisma filantropike në vend. Gjatë 8 viteve të monitorimit janë identifikuar 3,297 dhurime në total. **Viti 2022, shënon numrin më të lartë të rasteve të dhurimit**, përkatësisht 616 raste. Kjo vjen si rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit, solidaritetit, si dhe përdorimit të platformave crowdfunding, të cilat që prej fatkeqësisë natyrore të tërmetit të vitit 2019 dhe situatës pandemike janë përdorur gjerësisht për të mbështetur kauza sociale. **Lidhur me vlerën e dhurimeve, në total janë dhuruar 3,3 bilionë lekë.** Mobilizimi masiv, ndaj situatës së tërmetit të vitit 2019 solli një ndryshim në kulturën e dhurimit, humanizmit dhe solidaritetit ndërmjet shqiptarëve. Grupi i përfituesve mbetet i njëjtë ndër vite, ku fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të vecanta, dhe pa kujdes prindëror janë kategoritë që përfitojnë nga dhurimet.

Numri total i dhurimeve ndër vite



Vlera totale e dhurimeve ndër vite



I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D



SOLIDARITETI PËR
FËMIJËT & NJERËZIT
ME AFTËSI NDRYSHE

Ina Malhani



I n a M a l h a n i

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj? Cila është shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?

Unë quhem Ina Malhani, lindur në qytetin e Durrësit dhe aktualisht jetoj në Tiranë. Idhulli dhe modeli im, të cilën jam përpjekur gjithmonë ta ndjek është “Shën Nënë Tereza”. Sikurse Nënë Tereza, edhe unë kam një shtysë të brendshme: dëshirën për të ndihmuar njerëzit në nevojë, kjo është nisma ime. Në vendin tonë ka shumë njerëz në nevojë dhe të braktisur që u duhet një mbështetje, një fjalë e mirë, një dorë që u zgjatet për ndihmë a shërbim. Misioni të cilit i jam kushtuar gjatë gjithë jetës time është ti ndihmoj njerëzit të cilët ndodhen në vështirësi.

Cili ka qenë target grupi i mbështetur dhe në cilat zona/qytete është shtrirë mbështetja?

Target grupi të cilëve përqijem t'i gjendem pranë janë njerëzit në nevojë. Ndihamat kanë qenë në terma monetare gjithashtu dhe të mira dhe produkte, duke adresuar nevojat që institucionet publike, private dhe individët kanë patur. Qytetet ku kam kontribuar më shumë janë qyteti i Tiranës dhe i Shkodrës.



Disa prej institucioneve publike dhe private me të cilat kam bashkëpunuar janë Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, në Shtëpinë e të Moshuarve “Strehë e Shpresë Kuka”, Shtëpinë e të Moshuarve “Vatra e Ngrohtë” në Sauk, në Shtëpinë e të Moshuarve të personave me aftësi të kufizuar intelektuale të “Shoqatës Sandegjidio”, në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, në Shtëpinë e “Motrave të Nënë Terezës”, në shoqatën “Jetimi në Fokusin Tonë”, etj.

Gjithashtu jam munduar të kontribuoj tek fëmijët dhe familjet të cilat kanë nevojë për mbështetje në qytetet të ndryshme të Shqipërisë ku mund të përmend Librazhdin, Madhësinë e Madhe, Mirditë, Durrës, e Thumanë gjatë tërmetit të vitit 2019, Elbasan, Berat dhe Fier etj. Ndihamat ka qenë kryesisht në mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta, atyre pa kujdes prindëror, si dhe familje të Komunitetit Rom dhe Egjiptian por jo vetëm gjithashtu jam përpjekur të ndihmoj familje të mëdha apo me nevoja nga më të ndryshme të cilat kanë kërkuar ndihmën time.

SHKOLLA SPECIALE 3DHJETORI



Ina Malhani
Vullnetare



Cili ka qenë impakti i arritur deri tani nga nisma e ndërmarrë?

Bekimi i tyre është mirënjohja më e madhe që marr! Këtë e ndiej edhe tek personat që për hir të aftësive të kufizuara intelektuale dhe të veçanta e kanë të pamundur të shprehen, por me sytë e tyre më falin dashuri që është hyjnore. Mbi të gjitha unë i jam mirënjohëse familjes sime e cila në të gjithë veprimtarinë time ka qenë një shtyllë e fortë mbështetjeje pa të cilën sdo ja kisha dalë. Ashtu sikundër i jam mirënjohëse shumë individëve të cilët jetojnë jashtë vendit dhe u janë bashkuar nismave të miat për tju gjendur pranë e për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Një bashkëpunim i frytshëm është edhe me Shtëpinë e të Moshurave "Strehë dhe Shpresë Kuka", drejtuesit e të cilit kanë pranuar pranë ambjenteve të tyre shumë të moshuar në nevojë pa pagesë.

Unë e kam këtë mision dhe nuk do të ndalem sa të kem jetë. Siç thotë Nënë Tereza, "Kur nuk do të jeni në gjendje të ecni shpejt, ecni. Kur nuk do të jeni në gjendje të ecni, përdorni një shkop. Por kurrë mos u dorëzo!".

Cili është plani juaj për të ardhmen?

Plani im për të ardhmen është që të vazhdoj të ndihmoj njerëzit të cilët kanë nevoja shëndetësore, ekonomike, fëmijë dhe të rinj që janë pa kujdes prindëror. Ju falenderoj për bisedën dhe uroj që nesër të bëhemi edhe më shumë për tju ardhur në ndihmë atyre të cilët gjenden në vështirësi. Faleminderit e Zoti ju bekoftë!

Luis Artoni



LUIS ARTONI

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj? Cila është shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?

Unë quhem Luis Artoni dhe kam lindur në qytetin Mendoza, në Argjentinë. Prej gati një dekade kam vendosur të investoj kohën time dhe të jem pjesë e ndryshimeve, e të jap kontributin në të mirë të shoqërisë. Unë jam drejtor teknik profesional i futbollit të “Shoqatës së Futbollit Argjentinës – AFA” dhe “Federatës Ndërkombëtare të Shoqatës së Futbollit – FIFA”. Përmes veprimtarisë sportive, u vij në ndihmë fëmijëve, familjet e të cilëve janë në vështirësi ekonomike, fëmijëve me aftësi të veçanta, dhe fëmijë që vijnë nga grupe të marginalizuara. Prej muajt prill, studioj dhe punoj në Shqipëri dhe njëkohësisht jam vullnetar tek “Qendra Jonathan”.



Cili ka qenë target grupi i mbështetur dhe në cilat zona/qytete është shtrirë mbështetja?

Grupi të cilët mbështes janë personat e amputuar, personat që kanë humbur shikimin, dhe të rinjtë me sidromën Down. Aktualisht punoj si drejtor teknik i ekipit shqiptar të futbollit për personat e amputuar dhe merrem me stërvitjen e tyre. Gjithashtu, mbështes dhe shoqatën “VT Albania”, në Maminas, e cila ofron mbështetje për ata që vuajnë nga distrofia muskulare, paraliza cerebrale dhe kushte të tjera të ngjashme që e bëjnë lëvizshmërinë një sfidë. Në këtë qendër mbështes një grup prej 12 personash me aftësi të kufizuara. Unë drejtoj edhe përzgjedhjen e futbollistëve - persona që kanë humbur shikimin, një detyrë jo e lehtë për shkak të gjuhës dhe mungesës së infrastrukturës. Nga ana tjetër përmes qendrës Jonathan, po përgatisim ekipe sportive dhe sportistë të rinj me sindromën Down për të përfaqësuar Shqipërinë në lojërat e ardhshme Paraolimpike.

Cili ka qenë impakti i arritur deri tani nga nisma e ndërmarrë?

Motivimi që më shtyn të zhvilloj detyrat është për shkak të gëzimit dhe kënaqësisë së madhe që përjetoj kur shoh rezultate te atletët. Zbulimi se ata kanë arritje që i bëjnë të dukshëm për shoqërinë, duke u dhënë atyre mjete për të përmirësuar jetën e tyre të përditshme, duke i parë ata të ndihen krenarë për veten e tyre, është arsyeja pse unë investoj në to. Një tjetër nga shpërblimet e shumta është t'i shohësh ata të rriten duke u përshtatur natyrshëm me jetën e një komuniteti në shoqëri.

Cili është plani juaj për të ardhmen?

Plani im për të ardhmen është të formoj ekipe konkurruese në nivelin Paraolimpik. Gjithashtu për të zhvilluar dhe përgatitur një atlet me sindromën Down që të na përfaqësoj në lojërat olimpike.



Aktivitetet vullnetare nga
LUIS ARTONI




R R A T H Ë D H U R U E S

Në dhjetor u inagurua **“Nadja e mirë gjyshërit tanë”**, një nga nismat e mbështetuara përmes “Rrathë Dhurues, 2022”. Ndërkohë dy nismat e tjera *“Fëmijë të shëndetshëm, komunitete të shëndetshme!”* dhe *“Pop-up Book!”* janë drejt finalizimit të zbatimit. Për më tepër njihuni në seksionin e mëposhtëm.





#RrathëDhurues
Shqipëri



POP -UP BOOK!



FËMIJË TË SHËNDETSHËM, KOMUNITETE TË SHËNDETSHME!



NADJA E MIRË, GJYSHËRIT TANË!



Nadja e mirë, gjyshërit tanë!



R O M I N A K A L I

Bashkëthemeluese - Shoqata "Roots"

Të rinjtë, duke pasur potencial unik, energji, entuziazëm, optimizëm dhe kreativitet janë katalizatorët më të mirë të ndryshimit dhe përmirësimit të një komunitet. Por për t'a bërë këtë gjë, duhen mundësi dhe mbështetje. Ne e gjetëm këtë mundësi në eventin 'Rrathë Dhurues' të organizuar nga Partnerët Shqipëri, përmes dhuruesve, të cilët na besuan. Angazhimi i të rinjve në përmirësimin e komunitetit shërben për disa qëllime, jo vetëm për të përmirësuar kushtet aktuale të komunitetit, por edhe për t'u përgatitur për një gjeneratë të re të lidhjes dhe rëndësisë që ka kontributi i tyre në vendin e lindjes, ne e pamë si kënaqësi, kontribut, mision dhe si "detyrë" komunitare angazhimin tonë përmes kësaj nisme sociale.

Rinia është sinonim i ndryshimit, përparimit dhe së ardhmes. Si një organizatë rinore, e krijuar për fuqizimin e të rinjve, ne menduam se ku ka fuqizim më frytdhënës se ndihmesa ndaj atyre që kanë më shumë nevojë, për gjyshërit. Nën dëshirën e madhe që komuniteti t'i shtohet një hapësirë e bukur dedikuar gjyshërve, ne shpresuam dhe besuam se angazhimi ynë do të ishte një model, do të ishte një shtysë për të gjithë, për rëndësinë që ka çdo akt sado i vogël në komunitet.

Aplikuam në këtë event, me besimin se do të na jepej mundësia për ta vënë në jetë. Ashtu ndodhi. Një ndër pjesët më emocionuese, ishte prezantimi i idesë, e cila në fakt nuk kishte nevojë për shumë fjalë, sepse puna jonë do fliste vetë. E konsideruar si një punë publike, që duhej bërë nga institucionet publike, kjo për ne nuk kishte shumë rëndësi sepse puna jonë do të shërbente si mesazh për këdo që beson se vetëm instancat publike e kanë në dorë përmirësimin e komunitetit.

Për ne ambienti që do t'i dedikohej atyre, nuk ishte vetëm një nisëm që do të materializohej, por ishte më shumë se aq. Ishte një mendim i lindur për të ndihmuar, për të mbështetur, ishin disa zemra që do të gëzoheshin dhe ishte një shembull i dhënë se po deshëm të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla, por me dashuri të madhe. Impakti që pati ideja jonë nisi pa u zbatuar akoma. Gjatë kohës që intervistonim gjyshërit dhe gjyshet, urimet e tyre, shikimet e sinqerta dhe fjalët e bukura na bënë të kuptonim se sa e rëndësishme ishte ajo që po bënim. Jo vetëm ne, por shumë miq dhe kolegë u treguan të gatshëm për të na mbështetur që videoja me të cilën do të prezantohej nisma jonë të përçonte mesazhin që ne dëshironim. Na kujtohet që njëri nga gjyshërit, u gëzua fort jo vetëm për idenë, por sepse ne, të rinjtë, ishim kujtuar dhe kishim menduar për ta.

Sot, pasi e realizuam me sukses nismën tonë, jemi shumë të lumtur dhe besojmë fort në nisma sociale, në nismat që i bëjmë të gjithë bashkë, e forcojnë komunitetin dhe e kthejnë shoqërinë tonë në një vend ku e mira ndahet me të tjerët, ku njerëzit mbështesin për njëri-tjetrin, ku puna nuk bëhet vetëm për qëllime ekonomike, por përbën edhe një model dhe inspirim për të mbështetur ato që kanë nevojë. Nisma sociale dhe filantropia ndihmojnë në krijimin e një kulture të dhënies dhe përcjell qëndrime pozitive për ndihmën ndaj të tjerëve. Kjo është jetike për shoqërinë tonë, pasi përbën reagim qytetar, mirësi dhe ofron një ndjenjë të rëndësishme që askush nuk është vetëm.

smile.al



S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Nëntë nisma të organizatave jofitimprurëse u shpallën fituese dhe u publikuan në **platformën crowdfunding Smile.al**. Përmes kontributit online nga publiku, dhurimet do të mbështesin nevojat e komuniteteve lokale kryesisht të fokusuara në fushat e shëndetësisë, edukimit dhe veprimtarisë sportive

9 INICIATIVAT



Mbështet si një maratonmak!

Fushata ndërgjegjësuese për mbledhje fondesh zhvillohet në kuadër të Maratonës së Tiranës e cila këtë vit ndodh me 23 Tetor. Të gjitha të ardhurat shkojnë në mbështetje të Qendrës PRO PAK pranë Fondacionit Down Syndrome Albania. Në këtë qendër ofrohen shërbime terapeutike për 43 fëmijë me aftësi të kufizuara. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Ekipi i të Amputuarve Shqiptar 2019

Kjo iniciativë ka nisur si nxitje për të ndihmuar personat e amputuar për të bërë një aktivitet argëtues dhe për t'i ndihmuar që të ndihen më të integruar në shoqëri. Kjo është një mundësi për ti nxjerrë këta persona nga gjendja e zytme e asaj që u ka ndodhur dhe të bejnë një aktivitet sportiv që i ndihmon ata të integrohen në shumë aspekte sociale, fizike, emocionale etj. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Dhuro dhe Festo!

Projekti "Dhuro dhe Festo" synon të sjellë gëzim në jetët e dhjetë vogëlushëve nga komunitetet më në nevojë, të cilët kanë humbur njërin nga prindërit. Secilit prej fëmijëve do t'u organizohet një festë surprizë për ditëlindje me pjesëmarrjen e miqve, të afërmve dhe përmes kontributit tënd bujar. Fëmijët vijnë nga komunitetet më në nevojë në zonën e Tiranës, Durrësit e Shkodrës dhe disa prej tyre nuk kanë pasur asnjëherë mundësi të festojnë ditëlindjen me miqtë. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)

E R E J A



Mbështetje për gratë dhe fëmijët e dhunuar

Qëllimi i projekti synon ti mbështesë gratë dhe fëmijët e dhunuar me një paketë financiare për të përballuar minimalisht një periudhë një mujore (qera, pagesë energji/ ujë/ internet, ushqime, ves hje, medikamente). Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Rrugëtim i ndryshëm i njëjti destinacion

Ky projekt ka si qëllim të realizojë me fëmijët jetim të shtëpisë së fëmijës Zyber Hallulli në Tiranë një shfaqje teatri dhe nëpërmjet kësaj shfaqje të përcjelle në mënyrë indirekte argëtimin, edukimin, punën në grup, respektimin e hapsirës dhe të drejtave të tjetrit. Të dallojmë vlerën nga antivlerën dhe të afrohen më shumë me librin. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



KLUBI 'GO-3G'

Projekti synon që me fondet e dhuruara, të ndihmohen fëmijët e Shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri" për të rritur nivelin personal dhe social me anë të aktiviteteve jashtëshkollore. 106+ fëmijë do të aftësohen të ndërveprojnë mes njëri-tjetrit, anëtarëve të familjes dhe mjedisit rrethues. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Fëmijë aktivë, fëmijë të shëndetshëm

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në uljen e sedentaritetit dhe përmirësimin e aktivizimit fiziko-lëvizor të të rinjve, duke ndihmuar në zhvillimin e një fiziku të shëndetshëm. Në këtë formë rrisim ndërgjegjësimin e publikut për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me aktivitetin fizik dhe fokusohemi te përfitimet fizike, shëndetësore, emocionale nga zbatimi i projektit. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)




MIKE në lagjen time

Projekti do të sigurojë fokusim të shërbimit tek klienti. Nëpërmjet tij synohet të trainohen ekipet në përdorimin e platformes, pajisjen e tyre me Ipad dhe biçikleta për vizita të shpejta. Shërbimi synon fokusim të shërbimit tek klienti, parandalim, rritje të kënaqësisë së klientit, promovim të shërbimit të vetëkujdesit, punësim të të rinjve të cilët mbarojnë bachelor për infermjeri, rritje të kënaqësisë së tyre në punë , promovim të rolit të infermjerit në komunitet. Përdorimi i platformës ndihmon infermierët që 61% të kohës së punës së tyre ti përkushtohen klientit. Kujdesi do të paguhet, çmimi do të mbulojë kostot e shërbimit. OJF do ketë një fitim 5% për vazhdimësinë [këtu](#)



Trauma në fëmijërinë

Qëllimi i fushatës është të pajsim 60 fëmijët dhe 50 personat që punojnë me ta me mjete konkrete për të lehtësuar impaktin negativ të traumës (për shkak të abuzimit, dhunës në familje, neglizhimit, etj). Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



F U S H A T A
N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E N Ë
N E V O J Ë

Fushata

të ngritura gjatë muajve
qershor - dhjetor 2022.

#1

#Nisma të bukura dhe me shumë dashuri

Për festat e fundvitit nje grup mikeshash bënë dhurata të veçanta për fëmijët të moshës 0-6 vjeç frekuentues të Qendrës Jonatan në Tiranë.

#2


Rreth 14,000 dhurues bëhen bashkë dhe mbështetën kauzën e Romario Dragani dhe Gabriel Koka për ti ardhur në ndihmë shokut të tyre i cili pësoi një aksident automobilistik. Shuma e mbledhur prej 600,000 euro kontribuoi për një sërë trajtimeve mjekësore në Itali.

FESTAT E FUNDVITIT




KLEVIS GJELUCI









F O N D A C I O N E T
K O M U N I T A R E



Asistenca ndaj Fondacioneve Komunitare



Vijon asistenca e Partnerëve Shqipëri ndaj OJF-ve dhe grupeve joformale për funksionimin si fondacione komunitare në Shqipëri. Prej vitit 2022 dy organizata jo-fitimprurëse dhe një grup joformal po planifikojnë dhe zbatojnë iniciativat e para si fondacione komunitare, me mbështetjen e komunitetit, bizneseve lokale dhe institucioneve publike. Nismat do të vijojnë të zbatohen dhe promovohen gjatë vitit 2023.



Z H V I L L I M E
N G A
E V R O P A

Zhvillime nga Evropa



European Center for
Not-for-Profit Law

MAPPING FUNDRAISING FOR CSOs

A Monitoring Guide to the Regulatory Environment for Philanthropy

October 2022



Qendra Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL) shpalli në dhjetor ***“Hartëzimi i gjenerimit të të ardhurave për OJF-të: Një Udhëzues Monitorimi për Mjedisin Mundësues për Aktivitetin Filantropik”***. Udhëzuesi ofron mundësinë për të përcaktuar mjedisin ligjor dhe rregullator mbi dhurimet filantropike në nivel kombëtar. Qëllimi i këtij udhëzimi është identifikimi i praktikave më të mira dhe reformat në këtë drejtim.



Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania